

20 mars, 2007

## **Komunikatë për media**

### **Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpall Valën 24 të Privatizimit**

**PRISHTINË** – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) sot zyrtarisht shpalli valën 24 të Privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH). Menjëherë pas mbledhjes së Bordit të mbajtur më 7 mars, AKM-ja ka njoftuar menaxhmentin e NSH-ve dhe Komunitat përkatëse për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, ndërsa sot i ka postuar njoftimet për tender në faqen e AKM-së në internet, [www.kta-kosovo.org](http://www.kta-kosovo.org).

Në listën e tenderëve të privatizimit të valës së 24-të janë përfshirë 24 Ndërmarrje Shoqërore (NSH), nga të cilat janë krijuar 32 Ndërmarrje të Reja (Ndër. të Reja).

Të gjitha ndërmarrjet do të privatizohen përmes spinof-it të rregullt.

Afati i fundit për parakualifikim është me 16 maj, 2007.

Data për dorëzimin e ofertave është me 23 maj, 2007.

### **Bashkangjitur në këtë komunikatë për media mund të gjeni listën e plotë të kompanive:**

**Ndërmarrja e Re shitoret në Shtëpinë Bardhë Sh.P.K.** - ofron mundësi për blerjen e shtatë shitoreve, që ndodhen në ndërtesën e Shtëpisë së bardhë në rrugën e Nerodimes të Ferizajt. Sipërfaqja e përgjithshme e shitoreve është përafërsisht 224 m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re apartamentet në Shtëpinë e Bardhë Ferizaj Sh.P.K.** - ofron mundësi për blerjen të komplet katit banesor të gatshëm për përshtatje dhe finalizim që ndodhet në ndërtesën e Shtëpisë së bardhë në rrugën e Nerodimes të Ferizajt. Sipërfaqja e përgjithshme e apartamenteve është përafërsisht 622m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Barakat për shitje me pakicë Sh.P.K.** - përfshin dy objekte baraka që ndodhen në tokë të vet, në pjesën periferike të Ferizajt, e përshtatshme për tregti apo për qiradhënie shitësve me pakicë për qëllime komerciale. Sipërfaqja përgjithshme e barakave është përafërsisht 340 m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re 17 Nëntori tokë dhe objekte komerciale Ferizaj Sh.P.K.** - ofron mundësi të shkëlqyeshme për blerjen e 1.6 hektarë tokë së bashku me objekte të hapura prej përafërsisht 200 m<sup>2</sup> e përshtatshme për zhvillim komercial. Hapësira ndodhet në udhëkryq të rrugëve Prishtinë – Shkup dhe Ferizaj – Gjilan dhe afër një kilometër larg qendrës së Ferizajt. Ne besojnë se është rast i shkëlqyeshëm për zhvillim të bizneseve të ndryshme.

**Ndërmarrja e Re Agrokultura Fabrika për Përpunimin e Mishit Sh.P.K.** - tenderi i jep mundësi investitorit të marrë fabrikën për përpunimin e mishit në të vendosur në fshatin Velekincë (komuna e Gjilanit). Me blerjen e kësaj Ndërmarrje të Re do t'i hapet qasja në tregun Kosovar të ushqimit dhe do t'i lejohet mundësia e zgjerimit. Prona që është lëndë e këtij tenderi ka një sipërfaqe toke prej përafërsisht 58,180m<sup>2</sup> (05.81.80 ha). Ndërtesat kryesore përfshijnë përafërsisht sipërfaqen prej 10,027 m<sup>2</sup> dhe hapësirën e hapur - oborrin sipërfaqe të përafërt prej 48,153 m<sup>2</sup> në kuadër të kompleksit të fabrikës për përpunimin e mishit.

**Ndërmarrja e Re Tregtia Shitoret Sh.P.K.** - ofron mundësi për blerjen e dy hapësirave për shitje më pakicë më sipërfaqe përafërsisht prej 217m<sup>2</sup> dhe 44 m<sup>2</sup> dhe ndodhen afër qendrës së qytetit të Ferizajit.

**Ndërmarrja e Re Tregtia Administrata Sh.P.K.** - ofron mundësi për blerjen e zyrave në ndërtesën dykatëshe ku sipërfaqja e një kati është afro 202 m<sup>2</sup>, që ndodhen hapësirë prej 22.75 ari në zonën industriale të Ferizajit.

**Ndërmarrja e Re Zyrat e Bujkut Sh.P.K.** - gjendet në qendër të qytetit të Skenderajt/Sërbicës, Komuna e Skenderajt/ Sërbicës. Përmban tokë që ka sipërfaqe prej 837 m<sup>2</sup> (0 ha 8 ari 37m<sup>2</sup>) dhe ndërtesa tre katëshe. Vetëm të tre zyrat që gjenden në katin përdhes do të shiten në këtë tender. Sipërfaqja e të tre zyrave përafërsisht arin në 150 m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Dyqanet e Çyçavicës në Vushtri Sh.P.K.** - gjendet afër qendrës në Vushtri në anën e kundërt të Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës dhe ka një sipërfaqe përrreth 119.45 m<sup>2</sup> me dy dyqane në katin përdhes (Dyqani 1: sipërfaqe prej 59.725 m<sup>2</sup>; Dyqani 2: me sipërfaqe prej 59.725 m<sup>2</sup>).

**Ndërmarrja e Re Pylltaria Kodra e Runikut, Runik - Skenderaj Sh.P.K.** - i ofron investitorit potencial mundësinë ideale për të përfituar rreth 35921 m<sup>2</sup> (3ha 59are 21m<sup>2</sup>) tokë (kullosë) të përshtatshme për çdo llojë veprimtarie ,dhe me një lokacion shumë të mirë afër rrugës kryesore Runik-Pejë.

**Ndërmarrja e Re Fabrika e Lëkurës Bare Sh.P.K.** - i ofron investuesit potencial një mundësi të shkëlqyer për të privatizuar 10649 m<sup>2</sup> (1ha 06ari 49 m<sup>2</sup>) të tokës me ndërtesë e cila ka bazën dhe katin përdhesë me sipërfaqe përafërsisht prej rreth 1600 m<sup>2</sup>. Toka dhe ndërtesa janë të përshtatshme për çfarëdo lloj biznesi dhe gjinden në lokacion adekuat në fshatin Bare, në Mitrovicë/Mitrovica.

**Ndërmarrja e Re NT Klina – Shitorja nr.1 Sh.P.K.** - i ofron investitorëve një lokacion atraktiv për shitje me pakicë që gjendet në qendër të Klinës. Ndërtesa ofron një sipërfaqe prej rreth 88.1 m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Supermarketi i Korenikut – Rakosh Sh.P.K.** - ndodhet në qendër të fshatit Rakosh, në rrugën kryesore Pejë – Mitrovicë. Ndërmarrja e re ofron rreth 123 m<sup>2</sup> hapësirë të përshtatshme për aktivitete komerciale.

**Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Kryqi i Rakocit Sh.P.K.** - gjendet në zonat kadastrale Kryqi i Rakocit dhe në fshatrat përrreth Gërgoc, Radoniq dhe Zhabel. Kjo ndërmarrje ofron rreth 480 ha tokë bujqësore. Ky tender investuesit i jep rastin që të zhvillojë më tutje agro biznesin në këtë zonë.

**Ndërmarrja e Re Ferma e Pulave Ponoshec Sh.P.K.** - gjendet në zonën kadastrale të Ponoshecit. Kjo Ndër. e Re ofron përafërsisht 13 45 78 ha tokë dhe 12 ferma të pulave nga të cilat tri janë aktive. Ky tender investuesit i jep rastin që të zhvillojë më tutje agro biznesin në këtë zonë.

**Ndërmarrja e Re Elmont Sh.P.K.** - që është tenderuar përfshinë një ndërtesë administrative me një sipërfaqe prej 150 m<sup>2</sup>. Gjindet në sipërfaqe përafërsisht 12ari në qender të qytetit të Pëjës.Sipërfaqja ndodhet afër stacionit të trenit në Pejë dhe mundë të shërbejë për aktivitete të ndryshme afariste.

**Ndërmarrja e Re Hidromont Sh.P.K.** - përfshin sipërfaqen prej 12 ari e cila ndodhet në zonë komerciale tërheqëse,afër stacionit të trenit në Peje. Depoja e cila përfshihet në tokën e ofruar është pjesërisht e demoluar.

**Ndërmarrja e Re Pemishtet e Lajthive dhe Vishnjeve Sh.P.K.** - i ofron investitorit një sipërfaqe prej rreth 200 hektarësh tokë të punueshme bujqësore në Zonën kadastrale Glllogjan dhe Irznjq,në komunën e Deçanit. Toka bujqësore e tenderuar është pjesërisht kultivuar me drunjë të lajthive dhe qershive dhe gjithashtu ofron mundësinë për kultivimin për e kulturave të ndryshme bujqësore.

**Ndërmarrja e Re Drita - Shajkoc Tokë Bujqësore Sh.P.K.** - ofron tokë të mirë bujqësore në një pozitë të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve në ferma si shpeztaria dhe pemtaria. Me investime të duhura mund të arrihen rezultate të mira në produktet bujqësore. Toka bujqësore e ofruar përfshinë një sipërfaqe të përafërt prej 767768 m<sup>2</sup> (76 he 77 ari 68 m<sup>2</sup>) . Parcela e tokës ka qasje në rrugë.

**Ndërmarrja e Re Drita - Sfeqël Tokë Bujqësore Sh.P.K.** - ofron tokë të mirë duke e përfshir edhe një ndërtesë administrative. Me investime të duhura mund të arrihen rezultate të mira në produktet bujqësore. Toka bujqësore e ofruar mund të prodhoj drithra me kualitet të lartë si dhe produkte tjera bujqësore. Toka bujqësore e ofruar përfshinë një sipërfaqe të përafërt prej 787447 m<sup>2</sup> (78 ha 74 ari 47 m<sup>2</sup>) dhe ndërtesën administrative me një sipërfaqe përafërsisht prej 240 m<sup>2</sup>. Parcelat e tokave kanë qasje në rrugë.

**Ndërmarrja e Re Kosovaelektro Qafa Dyqani Sh.P.K.** - siguron investitorit potencial mundësinë për përfitimin e një dyqanit me lokacion strategjik në qendër të Prishtinës. Dyqani i ka sipërfaqe prej përafërsisht 109.57m<sup>2</sup> dhe gjendet në katin e dytë kompleksit të ndërtesës njohshme si 'Qafa'.

**Ndërmarrja e Re Kosovaelektro Administrata Sh.P.K.** - ofron lokacion atraktive për afarizëm prej përafërsisht 296m<sup>2</sup> në qendrën e Prishtinës afër Muzeut Kombëtar. Oferta përfshin objektet një-katshe prej përafërsisht 179m<sup>2</sup> me oborrin prej përafërsisht 117m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Turist Kosova Qafa Shop Sh.P.K.** - i jep mundësi investitorëve që të kenë një lokacion në një vend atraktiv, përafërsisht 159m<sup>2</sup>, në Prishtinë që përfshinë shkallët e hyrjes dhe zyret.

**Ndërmarrja e Re Mekanizimi Lipjan Sh.P.K.** - i ofron mundësi investitorit potencial për përfitimin e një prone afariste me sipërfaqe të përgjithshme rreth 8,637m<sup>2</sup> (86 are, 37m<sup>2</sup>) e cila gjendet në Lipjan. Kjo pronë përfshinë një kompleks për shitje, hapësirë depoje dhe sipërfaqe për shitje dhe servisim të veturave, makinerisë dhe pajisjeve bujqësore. Ky kompleks përfshinë ndërtesa me strukturë të fortë dhe metalike me sipërfaqe të përgjithshme rreth 1,916m<sup>2</sup>. Aty poashtu gjendet edhe një depo/garazh me rreth 226m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Gërmia - Toka Sh.P.K.** - i ofron mundësi investitorit potencial për përfitimin e pronës afariste me sipërfaqe të përgjithshme përafërsisht 25,000m<sup>2</sup> (2ha e 50ari) në lokacion kyç në Zonën Industriale- Prishtinë në afërsi të rrugës kryesore për në Fushë Kosovë dhe Aeroportin Internacional të Prishtinës.

**Ndërmarrja e Re Gërmia Shitoret Fushë Kosovë 1 Sh.P.K.** - i ofron mundësi investitorit potencial për përfitimin e një prone afariste me sipërfaqe të përgjithshme rreth 293m<sup>2</sup> në lokacion qëndror në rrugën kryesore në Fushë Kosovë. Pronat gjenden në përdhese të ndërtesës për banim dhe janë si njësi të veqanta: Shitorja nr.86 me rreth 75m<sup>2</sup> , Shitorja nr.10 me rreth 75m<sup>2</sup> dhe Supermarketi nr.55 me rreth 143m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Urata Supermarketi Nr. IV Sh.P.K.** - ofron mundësinë investitorit për përfitimin e dy pronave afariste që gjenden në katin e përdhese të një ndërtese dy katëshe në rrugën Nazim Gafurri në afërsi të qendrës së Prishtinës. Sipërfaqja afariste është 175 m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Llapi Shitorja Nr. 26 Sh.P.K.** - ofron investitorit potencial një mundësi unike që të fitojë një shitore që gjendet në qendër të Podujevës, në rrugën „Zahir Pajaziti“ me një sipërfaqe përafërsisht prej 54 m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Drithnaja Toka Sh.P.K.** - ofron një mundësi për një copë toke që përfshin një ndërtesë në një vend primar në Prishtinë ku zhvillimi i biznesit është duke ndodhur. Kjo hapësirë e ofruar përmban një sipërfaqe prej përafërsisht 5400 m<sup>2</sup>, përfshirë 4 depo me një sipërfaqe përafërsisht prej 1306 m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Shkabaj Sh.P.K.** - investuesit potencial i ofron një mundësi të shkëlqyer për të përvetësuar tokë shumë të mirë bujqësore shumica e së cilës tokë është nën infrastrukturën e ujitjes të Kompanisë së Ujitjes Ibër Lepenc. Ndërmarrja përbëhet prej rreth 150 hektarësh të tokës bujqësore të ndarë në këto zona kadastrale: Shkabaj/Orlloviq, Prishtinë, Krushefc, Fushë Kosovë. Ndërmarrja e Re po ashtu ka njësinë për servisimin e makinerisë me makinerinë bujqësore në fshatin Shkabaj.

**Ndërmarrja e Re Zhupa Reçan – Supermarketi në Gornje Selo Sh.P.K.** - përfshinë Supermarketin i cili gjindet në pjesën atraktive të fshatit Gornje Sello, me një sipërfaqe prej përafërsisht 2 ari që përfshinë ndërtesën një katëshe me sipërfaqe totale prej 55m<sup>2</sup> dhe 145m<sup>2</sup> oborr të regjistruara në emër të NSh-së.

**Ndërmarrja e Re Prizrencoop Gjonaj Depo Sh.P.K.** - prona e ndërmarrjes për tu bartur në subjektin e ri përmban ndërtesën/depot që ndodhet në pjesën atraktive të Prizrenit dhe përmban një sipërfaqe prej përafërsisht 21.00 ari. Depot aktualisht janë dhënë me qira palës së tretë.

Dita e fundit për parakualifikim është: 16 maj 2007

Dita për dorëzimin e ofertave është: 23 maj 2007